



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:043236

Datë: 10.11.2023

Numri i dokumentit: 04903903

C.nr. 314/22

GJYKATA THEMELORE NE PEJË-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Besnik Shala, ne çështjen juridike kontestimore të paditësit R.B, Komuna e Deçanit të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. F.K nga Peja, kundër të paditurës M.Sh e përfaqësuar nga A.Sh, me bazë juridike mos përmbushje e kontratës, vlera e kontestit 500 euro, në seancën publike të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt. 27.10.2023, në prani të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të autorizuarit të paditurës, dhe me dt. 10.11.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet në tersi kërkesë padia e paditësit R.B, Komuna e Deçanit ashtu që:

- I. DETYROHET** e paditura M.SH ti paguaj shumën prej 360 euro, në emër të një page të pa paguar, sipas kontratës së punës të datës 10.09.2021, e këtë me kamatë ligjore prej 8 % në vit nga data 03.03.2022 (data e parashtrimit të padis) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- II. OBLIGOHET** e paditura M.SH ti paguaj paditësit R.B, Komuna e Deçanit shumën prej 200.40 në emër të shpenzimeve të procedurës dhe atë në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj me datë 03.03.2022, ka ushtruar padi kundër të paditurës me bazë juridike mospërmbushje e kontratës, vlera e kontestit 500 euro.

I autorizuari i paditësit me padi, gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tersi pranë thënieve nga seanca e sotme ku dhe njëherë ritheksojmë se e paditura ka qene e njoftuar për mos pagesën dhe duke pasur parasysh edhe përgjigjen në padi e cila është paraqitur në këtë gjykatë me dt. 07.04.2022, dhe që nga ajo kohë dhe në vazhdimësi e ka pranuar këtë borxh prej 360 euro mirëpo asnjëherë nuk ka vepruar në drejtim të përmbushjes, se këtij obligimi si rrjedhojë e kontratës së punës, për çka i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkesën e saj ta e provoj në tersi si të bazuar dhe atë me kamate ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë, ku njëherë it i kërkojmë dhe shpenzimet procedurale për përpilimin e padisë shumën prej 78 euro, për një seancë gjyqësore shumen prej 101.40 euro dhe për taksën gjyqësore shumen prej 21 euro.

I autorizuari i të paditurës me përgjigje në padi ka deklaruar se e ka marrë konfirmimin se paditësit me të paditurën kanë lidhur kontratë pune nga dt.10.09.2021 deri me dt.09.12.2021, si staf-teknik mbështetëse në Spitalin e Pejës, po ashtu kemi marrë konfirmimin se e paditura MSH nuk ia ka bërë pagesën për muaji dhjetor, dhe tek divizioni i burimeve njerëzore në MSH është evidentuar se paditësi ka dhënë dorëheqje me dt.10.11.2021, dhe sipas raportit të Spitalit të Pejës figuron se paditësi i ka realizuar orët e punës sipas kontratës, dhe nuk i është bërë pagesa në vlerë prej 360€ sipas kontratës, po ashtu MSH e njofton gjykatën se po sa të përfundohet pagesa do të iu dërgojmë urdhër pagesën-dëshminë, se është përmbushur detyrimi.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata ka zhvilluar procedurën dhe sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova: kontrata e punës për kohe të caktuar e dt, 10.09.2021, qarkullimi për llogari të lëshuar nga NLB për R.B, forma mujore e vlerësimit të shërbimeve e dt. 02.12.2021, letërnjoftimi kopje për paditësin, emali i dt. 20.10.2023, e po ashtu pati parasysh edhe deklaratimet e të autorizuarit të paditësve dhe të përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit.

Gjykata në seancat e shqyrtimit kryesor pas administrimit dhe analizimit të provave, secilën veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën e në kuptim me dispozitën e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore - LPK-së, vendosi si në dispozitave të këtij aktgjykimi.

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi kishte lidhur kontratë me të paditurën për kohë të caktuar dhe atë me datë 10.09.2021, dhe në bazë të kësaj kontrate paga mujore ka qenë e paraparë të jetë në shumë prej 360 euro

Nga qarkullimi për llogari i lëshuar nga NLB Bank gjykata ka konstatuar se paditësit nuk i është bërë pagesa për një pagë mujore dhe atë për muajin dhjetor, ku këtë fakt e ka pohuar edhe vet e paditura me anë të përgjigjes në padi të datës 08.04.2022,

Andaj duke u bazuar në nenin 321 par. 2 të LPK-së i cili parasheh “*Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor*”, pra me vet faktin se pala e paditur e ka pohuar faktin se e njëjta nuk i ka përmbushur obligimet të cilat kanë ardhur si rezultat i kontratës së punës së datës 10.09.2021, të lidhur në mes palëve ndërgjyqëse ku kjo duke u bazuar në nenin 55 par. 1 në ligjin e Punës i cili ka paraparë “*I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit*” dhe paragrafi 2 i po të njëjtit nen “*Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.*” Pra paditësit i takon e drejta në kompensim të një page të pa paguar.

Sipas dispozitës së nenit 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) parashihet se “*kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e kësaj dispozite ligjore dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj borxhin në shumat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin për kamatën e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, pasi që gjykata konsideron se nga momenti i parashtrimit të padisë në gjykatë (data 03.03.2022) pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, se nga ky moment kupton për dëmin e shkaktuar, andaj edhe është vendosur si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, kreu XXVIII, Procedura në kontestet e vlerës së vogël, sqaron procedurën e kontesteve të vlerës së vogël në të cilat kërkesa nuk është më e madhe se 500 euro, dhe sipas dispozitës së nenit 491.1, 2,3 dhe 4 të LPK-së, parashihet së aktgjykimet dhe aktvendimet me të cilat përfundon procedura në kontestet të vlerës së vogël,

mund të goditën vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave me rendësi esenciale të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar së drejtës materiale të cilat shkaqe për të cilat mund të goditet vendimi gjykata është e detyruar ti theksoj dhe se afati ligjor për goditjen e këtyre vendimeve dhe për përmbushjen e tyre është 7 ditor.

Vendimin që e paditura ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, 453, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e palës paditëse ne këtë procedurë si dhe duke u mbështetur në tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë shumen prej 200,40 euro, (lartësia e shpenzimeve të procedurës i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë për: përpilimin e padisë shumën prej 78 euro, taksën për padi shumën prej 21 euro, për një seanca të mbajtura 101.40 euro).

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:043236- C.nr. 314/22, 10.11.2023

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa, në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit se të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate, dhe vetëm për shkelje të dispozitave të ligjit për procedurën kontestimore dhe për shkak të aplikimit të gabuar të se drejtës materiale.